



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 164, datë 12.3.2025

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.440,
DATË 17.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE TË AKREDITIMIT TË OFRUESVE
TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM
PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Kudo në përmbajtjen e vendimit, fjalët “... Qendra Kombëtare e Edukimit (në vijim (QKEV) ...)” zëvendësohen me “... Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, (në vijim ASCK) ...”.
2. Në ndarjen V bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:
 - a) Në pikën 1, në fund të fjalisë së parë, pas fjalëve “... të kufizuar ose të pakufizuar ...” shtohen “... në shërbimin *on-line*, që ofrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”;

b) Në pikën 2, fjalët "... të dorëzojë në QKEV ..." zëvendësohen me "... të ngarkojë në shërbimin *on-line*, që ofrohet nga ASCK-ja, nëpërmjet portalit "*e-Albania*" ...".

3. Fjalja e dytë, e ndarjes VIII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Çdo ankesë paraqitet në shërbimin *on-line*, që ofrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, nëpërmjet portalit "*e-Albania*" dhe shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështesin ankimin."

4. Pas ndarjes IX shtohet ndarja X, me këtë përmbajtje:

"X. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë në proces shqyrtimi nga struktura përkatëse e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, në kohën e paraqitjes së tyre.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

ALBANA KOÇIU

NR.PROT. 128513
DATE 19.3.2025

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT
SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Në mungesë dhe me porosi

Herald JONUZAJ

